



Kosova dhuron 2022


RAPORTI MBI GJENDJEN E FILANTROPISË

SI E NXISIN QYTETARËT MBLEDHJEN MASIVE TË FONDEVE NË KOSOVË?

Dhënia masive individuale përfaqëson raste të filantropisë të mbledhura masivisht nga qytetarët, si përmes modelit të mbledhjes së fondeve nga grupe njerëzish në internet (crowdfunding), kutive të donacioneve, ngjarjeve, etj. Për periudhën në të cilën kemi regjistruar të dhënat (2018-2022), ka pasur një rritje të vazhdueshme të numrit të dhënies masive individuale në Kosovë, nga 108 në 161.


Megjithatë, shuma e mbledhur nga këto veprime nga viti në vit është rritur edhe më shumë. Në vitin 2022 kemi shënuar një rritje të sasisë së regjistruar mbi 160% krahasuar me vitin 2021. Kjo tregon një rritje të rëndësishme të angazhimit të qytetarëve në filantropi.

Trendet në dhënien masive individuale




Cilat kauza u mbështetën përmes dhënies masive individuale në vitin 2022?

Në vitin 2022, dhënia masive individuale e qytetarëve u drejtua në masë të madhe drejt zbutjes së varfërisë. Kjo kauzë u mbështet në më shumë se 60% të rasteve të regjistruara të dhënies.



Kush ishin përfituesit e dhurimeve masive individuale në vitin 2022?

Organizatat e shoqërisë civile (OShC) kanë qenë përfituese në gati 80% të rasteve të dhënies masive individuale në vitin 2022. Krahasuar me 46% të vitit 2021, kjo shënon një rritje të dukshme të përfshirjes së OShC-ve në mbledhjen e fondeve të brendshme masive individuale.



Njerëzit në nevojë ekonomike kanë qenë përfitues në 67.6% të rasteve të dhënies masive individuale në Kosovë në vitin 2022, një përqindje më e madhe krahasuar me 53.4% të vitit 2021.



Pavarësisht rritjes së angazhimit të qytetarëve, shumica e rasteve të dhënies masive individuale mbeten të fokusuar në efektet afatshkurtra, me vetëm 4.2% që kanë efekte strategjike dhe afatgjata.

Dëshironi të dini më shumë? Të gjitha informacionet për dhënien masive individuale në Kosovë mund t'i gjeni [në këtë link](#).

Burimi: kosovadhuron.org



Kjo infografikë është bërë e mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Catalyst Balkans dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Programi për Angazhim Qytetar në Kosovë është një iniciativë pesë vjeçare zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).